

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7042
E mërkurë, 8 nëntor 2023
Çmimi 0.50 €

Raporti i Progresit i qorton Kosovën dhe Serbinë për moszbatimin e marrëveshjeve I FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

I DËRGUARI I POSAÇËM I BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI,
MIROSLAV LAJÇAK, KA QËNDRUAR DY DITË NË KOSOVË, PËR TË BISEDUAR
PËR DRAFT-STATUTIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE I FAQE 4-5

LAJÇAKU PËRFUNDON VIZITËN PËR ASOCIACIONIN, OPOZITA KËRKON HOLLËSI RRETH DRAFT-STATUTIT TË RI



Emisari evropian Miroslav Lajçak ka përmbyllur të martën vizitën dyditore në Kosovë, duke zhvilluar takime me përfaqësuesit e partive opozitare dhe me ambasadorët e akredituar në Kosovë, me të

cilët ka biseduar për draft-statutin e ri të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Përfaqësuesi i PDK-së dhe ai i LDK-së kërkuan të dinë më shumë hollësi rreth draft-statutit dhe u ankuan se po

mbahen "në terr" për shkak të mosparaqitjes së dokumentit, ndërsa lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, pretendoi se në takim opozitarëve u është paraqitur draft-statuti dhe e kanë lexuar në tërësi

AKTUALE



KMDLNJ: REGJISTRIMI I VETURAVE
FALAS PËR QYTETARËT E VERIUT,
DISKRIMINIM NË BAZA ETNIKE F. 7

SHOIPËRIA DO TË PRESE
EMIGRANTË, ITALIA DO TA
FINANCOJË STREHIMIN E TYRE F. 6

DEDAJ VAZHDON DËSHMINË:
KËRKOVA QË SEANCAT
TË JENË TË MBYLLURA
QË TË MOS MË RREZIKOHET
E ARDHMJA DHE FAMILJA F. 5

EKONOMI



PARATË E FALSIFIKUARA,
DEKLARATË E INSTITUCIONEVE:
QYTETARËT TA SHMANGIN
PËRDORIMIN E DY EUROVE, T'I
SHFRYTËZOJNË KARTELAT BANKARE F. 8

**KOSOVA DHE
TURQIA ZOTOHEN
PËR FORCIM TË
MARRËDHËNIEVE
NË POLITIKËN E
JASHTME I FAQE 7**



**PEZULLOHET
PROTESTA E
PARALAJMËRUAR
NGA PJESËTARËT
E NJËSIVE
ELITARE, KURTI
PREMTON
ZGJIDHJE I FAQE 7**



**KOMUNAT GRUMBULLOJNË
42.3 MILIONË EURO NGA
TË HYRAT E TATIMIT NË PRONË F. 8**

SPORT



**NDESHJA KOSOVË - IZRAEL
DO TË ZHVILLOHET ME TIFOZË F. 10**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni dhe Netanyahu, pa marrëveshje për një pauzë humanitare në Gazë

WASHINGTON, 7 NËNTOR - Presidenti amerikan Joe Biden nuk ka arritur një marrëveshje gjatë bisedës telefonike që zhvilloi më 6 nëntor me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu lidhur me nevojën për një pauzë humanitare në luftën Izrael - Hamas.

Zëdhënës i Këshillit për Siguri Kombëtare i ShBA-së, John Kirby, tha se ShBA-ja "do të vazhdojë të avokojë për pauzë të përkohshme dhe të lokalizuar të luftimeve".

Numri i palestinezëve të vrarë në luftën mes Izraelit dhe grupit militant palestinez Hamas ka tejkaluar shifrën prej 10 000 personash, ka raportuar Ministria e Shëndetësisë në Gazën e udhëhequr nga Hamas. Sipas kësaj ministrie, mbi 4 100 viktima ishin fëmijë dhe 2 640 gra. I pyetur nëse kjo shifër e viktimave do të bëjë që ShBA-ja të mendojë që ta ndërpresë mbështetjen për Izraelin, Kirby tha: "Mendoj se të gjithë ne duhet ta kujtojmë pse ata [Izraeli] po

luftojnë" duke iu referuar sulmit të Hamasit ndaj Izraelit më 7 tetor.

Gjatë këtij sulmi në jug të Izraelit, Hamasi vrau mbi 1 400 persona dhe sulmi nxiti nisjen e luftës. Kirby insistoi se "asnjë shtet" nuk do të toleronte një sulm të tillë "pa një përgjigje të shpejtë dhe agresive". Megjithatë, ai tha se ShBA-ja ka zhvilluar bisedime "të sinqerta" me izraelitët lidhur me përpjekjet për ta zvogëluar numrin e viktimave në mesin e civilëve.



Gjermania ndan miliona euro ndihmë për palestinezët

BERLIN, 7 NËNTOR - Gjermania ka vendosur që të ndajë 71 milionë euro ndihmë, si pjesë e shqyrtimit të vazhdueshëm të mbështetjes së saj për palestinezët. Berlino, po ashtu, është zotuar se do të japë 20 milionë euro shtesë në financimin e ri, tha Ministria e Zhvillimit më 7 nëntor.

Gjermania i është përgjigjur sulmit të përgjakshëm të militantëve palestinezë të Hamasit ndaj Izraelit më 7 tetor, duke pezulluar përkohësisht ndihmën për zhvillim për territoret palestineze dhe duke thënë se ndihma do të shqyrtohet. "Për shkak të situatës së brishtë në rajon, shqyrtimi ende nuk është kompletuar", u tha në deklaratën e Ministrisë së Zhvillimit.



Megjithatë, ministria tha se shqyrtimi është fokusuar në vazhdimin e mbështetjes për agjencinë e Kombeve të Bashkuara për refugjatët palestinezë, e njohur me shkurtesën UNRWA, duke pasur parasysh nevojat e banorëve në Rripin e Gazës dhe situatën gjithnjë e më të paqëndrueshme në shtetet fqinje.

Shuma totale prej 91 milionë eurosh është destinuar për shërbimet bazike për personat e zhvendosur në Rripin e Gazës dhe për ndihmë për refugjatët palestinezë në Jordani. Izraeli ka nisur fushatë për t'i zhdukur militantët palestinezë të Hamasit dhe po kryen sulme shkatërruese në Rripin e Gazës.

Nëntë vjet burgim më pak për Gruevskin

SHKUP, 7 NËNTOR - Ish-kryeministrin maqedonas Nikolla Gruevski i duhet të vuajë vetëm tre vjet e gjysmë burgim nga 25 vjet e gjysmë sa është dënues për vepra të ndryshme penale gjatë qeverisjes së tij nga viti 2006 deri në vitin 2016. Nikolla Gruevski është arratisur në Hungari në vitin 2018, pas ndjekjes nga organet gjyqësore maqedonase për shpërdorim të detyrës zyrtare. Gjykata e Apelit të hënën ka vendosur ndërprerjen e të gjitha procedurave për rastin "TNT", që ka të bëjë me shembjen e një objekti afarist në vitin 2011 për shkak të vjetërsimit të lëndës, raporton REL. Për këtë vepër Nikolla Gruevski ishte dënues me 9 vjet burgim, nën akuzën për shpërdorim të detyrës dhe rrënim të objektit si hakmarrje politike. Vlera e dëmit të shkakuar llogaritet të ketë qenë rreth 11 milionë euro.

Fijat Canoski, pronar i këtij objekti të rrënuar, i ka akuzuar organet gjyqësore për manipulim të procesverbalit me qëllim shpëtimin e Gruevskit. "Gruevski dhe mafia janë përgjegjësit

kryesorë për rrënimin e objektit, ndërsa gjykata ka bërë shpërdorim të detyrës duke falsifikuar procesverbalin e aktvendimit gjyqësor. Kanë lënë boshllëqe që gjatë ankesës në shkallën e dytë gjykimi të mund të anulohet ose të vjetërsohet. Ky shpërdorim është bërë nga shumë njerëz gjatë procedurës në shkallën e parë, por edhe në Apel", ka thënë Canoski. Me shtatë vjet burgim ish-kryeministri Gruevski ishte dënues për disa parcela tokë ndërtimore në një zonë atraktive në malin "Vodno" të Shkupit, por edhe kjo lëndë është në gjykim të shkallës së dytë të Apelit dhe me ndryshimet në Kodin Penal pritet të vjetërsohet.

Me gjashtë vjet burgim ai është dënues për shpërdorim të detyrës për ndërtimin e selisë së VMRO DPMNE-së në qendër të Shkupit, por kjo lëndë është në procedurën e vlerësimit në Gjykatën e Apelit. Kryeministri Dimitar Kovaçevski ka hedhur poshtë akuzat se pas vendimeve të gjyqësorit qëndrojnë partitë në pushtet me qëllim



kthimin e Nikolla Gruevskit në Maqedoninë e Veriut për qëllime politike, konkretisht për ndërhyrjen e tij në VMRO DPMNE për sigurimin e mbështetjes së tij për ndryshimet kushtetuese. Paraprakisht Gjykata e Apelit ka shfuqizuar edhe një lëndë për shpërdorim të detyrës nga ana e Nikolla Gruevskit për ndërtimin e autostradës Kërçovë - Ohër. Për këtë vepër ai pritet të dënohet me së paku shtatë vjet burgim për shkak të dëmtimit të buxhetit të shtetit për 155 milionë euro.

Ndërkaq në fuqi mbetet vetëm dënimi për shpërdorim të detyrës për furnizimin e qeverisë me një makinë luksoze në vlerë prej 600 mijë eurosh, për të cilën vepër Gruevski ishte dënues me dy vjet burgim.

Në fuqi mbetet edhe një gjykim tjetër për dhunën e ushtruar në një komunë të Shkupit ndaj një zyrtari opozitar që ishte bërë me urdhër të Nikolla Gruevskit dhe ai ishte dënues me 18 muaj burgim. Ish-kryeministri maqedonas po përballet edhe me dy gjykime të

tjera për dhunën në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, më 27 prill 2017 dhe ndërhyrjen në proceset zgjedhore. Këto vepra nuk përfshihen në ndryshimet në Kodin Penal, por ai synon që nga gjykimi për to të "shpëtojë" me kthimin eventual të vendimit për falje të miratuar nga ish-presidenti maqedonas, Gjorge Ivanov, më 12 prill 2021, kur i kishte falur të gjitha zyrtarët e akuzuar për vepra të ndryshme penale.

Përveç dënimeve me burgim, atij, me vendime gjyqësore të formës së prerë, i është sekuestruar edhe pasuria për dëmet që i ka shkakuar buxhetit të shtetit për disa miliona euro.

Por, Agjencia për Menaxhim të Pasurisë së Sekuestruar e Maqedonisë së Veriut ende nuk ka nisur procedurën për shitjen e pronës së tij.

Ekspertët juridikë kanë tërhequr vërejtjen që institucionet të kenë kujdes me sekuestrimin pasi në rast të lirimit nga të gjitha gjykimet, Gruevski mund ta kërkojë kthimin e pronave.

Raporti i Progresit i qorton Kosovën dhe Serbinë për moszbatimin e marrëveshjeve

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Komisioni Evropian (KE) i ka qortuar Kosovën dhe Serbinë për moszbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE) në raportet e tij të progresit për të dyja vendet të cilat pritet të publikohen të mërkurën.

“Radio Evropa e Lirë” e ka parë një draft të raportit prej 150 faqesh, në të cilin vlerësohet përmbushja apo mospërmbushja e kriterëve nga ana e Kosovës, si dhe e rekomandimeve që ka dhënë KE-ja në raportet e mëhershme.

Kosova ka bërë “përparime të kufizuara” në përmbushjen e standardeve të nevojshme për t’iu bashkuar BE-së. Ky është vlerësimi më i shpeshtë në Raportin të cilin KE-ja pritet ta miratojë më 8 nëntor, pas takimit të Kolegjit të Komisionarëve.

Por, në raportet e këtij viti, si në atë për Kosovën, ashtu edhe në atë për Serbinë, një vëmendje e shtuar i është kushtuar përmbushjes së detyrimeve që dalin nga dialogu i Brukselit, dhe në këtë çështje të dyja vendet qortohen për moszbatimin e tyre.

Normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë është vlerësuar me tekstin e njëjtit në të dyja raportet individuale të progresit, për secilin vend përkatës, pasi këto obligime janë pjesë e kriterëve edhe për avancim në procesin e integritimit evropian.

Duke e rikujtuar arritjen e Marrëveshjes në Bruksel në shkurt dhe dakordimin për aneksin për zbatimin e saj një muaj më vonë në Ohër, raporti shpreh keqardhje që palët nuk kanë filluar ende t’i kryejnë obligimet e tyre.

Marrëveshja Bazë dhe aneksi i saj kërkojnë palëve të zhvillojnë marrëdhënie normale të fqinjësisë së mirë, t’ia njohin njëra-tjetres dokumentet relevante dhe simbolet kombëtare. Për Kosovën, marrëveshja nënkupton njohje de facto nga Serbia, ndërsa për këtë të fundit aneksi i saj parasheh që Kosova ta formojë një Asociacion të Komunave me Shumicë Serbe.

“Si Kosova, ashtu edhe Serbia, akoma nuk e kanë filluar zbatimin e obligimeve të tyre përkatëse, të cilat dalin nga Marrëveshja, të cilat janë të vlefshme dhe detyruese për palët, dhe pjesë e rrugëtimit të tyre evropian. Palët urgjentisht duhet ta nisin angazhimin më konstruktiv dhe ta nisin zbatimin pa vonesa të reja, apo parakushte”, thuhet në Raportin e Progresit.

Raporti nënvizon detyrimin e Kosovës për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë pikë, dokumenti thekson se drafti i parë i statutit të Asociacionit, i cili ishte paraqitur në takimin e nivelit të lartë të dialogut në muajin maj, e që praktikisht ishte draft i Serbisë, “nuk ka qenë në përputhje me marrëveshjet relevante nga dialogu”.

Raporti tani kërkon që Asociacioni të themelohet në bazë të propozimit të fundit që palëve u është dhënë më 21 tetor. “Nga

Kosova pritet ta nisë procesin i cili çon deri te themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë serbe bazuar në propozimin evropian, i cili u propozua para palëve më 21 tetor 2023, dhe nga Serbia kërkohet ta mbështesë këtë proces dhe paralelisht ta fillojë përmbushjen e obligimeve të veta kyçe nga Marrëveshja”, paralajmëron raporti, i cili bën thirrje që “formalitetet, përfshirë edhe ato që lidhen me miratimin, nuk duhet të jenë pengesa në rrugën e progresit në zbatimin”.

Raporti e quan tërheqjen e serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022 dhe bojkotin e tyre të zgjedhjeve lokale të prillit të vitit 2023 si “shkelje të obligimeve të Serbisë nga dialogu, që paraqet kthim të madh mbrapa të Serbisë në përmbushjen e obligimeve nga marrëveshja e parë për parimet për normalizimin e marrëdhënieve dhe shkelje direkte të marrëveshjes për drejtësinë të vitit 2015”.

Ai i bën thirrje Serbisë t’i nxitë serbët e Kosovës “që menjëherë të kthehen në institucione”, ndërsa i bën thirrje Kosovës ta bëjë të mundur një gjë të tillë. “Që nga nëntori i vitit 2022 asnjëra palë nuk e ka bërë asnjë hap në këtë drejtim”, thuhet në raport.

Lista Serbe deri në nëntor të vitit të kaluar kishte pushtet absolut në nivel qendror dhe lokal, kur serbët nga veriu i Kosovës, me iniciativën e tyre, u larguan nga institucionet e Kosovës.

Një vendim i tillë është marrë me qëllim që Qeveria e Kosovës të mos zbatojë vendimin për heqjen e targave, të cilat lëshohen nga autoritetet serbe për qytetet e Kosovës.

Ndërkohë, në prill, Kosova mbajti zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, por serbët i bojkotuan ato. Kështu, kryetarët shqiptarë erdhën në pushtet në fund të majit, por popullsia shumicë serbe nuk i pranoi, gjë që shkaktoi protesta dhe krizë tjetër politike.

Kosova është shprehur e gatshme t’i mbajë zgjedhjet përmes një udhëzimi administrativ, i cili ua mundëson qytetarëve të komunave përkatëse t’i shkarkojnë kryetarët e tyre duke e nënshkruar atë.

Raporti përmend edhe disa obligime të tjera nga dialogu, të cilat nuk janë zbatuar, përfshirë edhe hapjen e urës mes Mitrovicës së Jugut dhe asaj të Veriut, marrëveshjen për energjinë e të tjera. Serbia përmendet si palë e cila nuk zbaton as marrëveshjen për kadastrat dhe diplomat universitare.

Nga Serbia kërkohet të bëjë më shumë edhe në rifillimin e takimeve të rregullta për zbatimin e marrëveshjes për menaxhimin e përbashkët të kufirit (IBM), për mbylljen e rrugëve ilegale për kalimin e vijës kufitare dhe ta zgjidhë çështjen e lëshimit të targave të veturave “pasi kjo çështje ka potencial të shkaktojë tensione



në Kosovë”.

Kosovës dhe Serbisë u kërkohet të kenë “sjellje konstruktive” në nismat rajonale. Për më tepër, Serbisë i kërkohet t’i respektojë obligimet për pjesëmarrjen e Kosovës, ndërsa Kosovës të mos i mbajë të bllokuara proceset siç bën, sipas këtij raporti, si në rastin e CEFTA-s.

Tensionet në veri të Kosovës

Raporti i Progresit i këtij viti i përshkruan me kujdes tensionet në veri të Kosovës, duke ardhur në përfundim se të dyja palët kanë ndikuar të ketë kriza të tilla për shkak të veprimeve të tyre. Kosova, sipas raportit, ka ndikuar në rritjen e tensioneve me praninë e shtuar të njësisve speciale të policisë dhe me Ligjin për Shpronësim në Veri, ndërsa Serbia me tërheqjen e serbëve nga institucionet dhe bojkotimin e zgjedhjeve lokale.

Në veçanti, raporti flet për ngjarjen më të rëndë që ka ndodhur në këtë periudhë: sulmin ndaj Policisë së Kosovës nga një grup i serbëve të armatosur në fshatin Banjskë të Zveçanit.

Megjithëse në deklaratat publike të përfaqësuesit të lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, ky sulm është cilësuar “terrorist”, Raporti i Progresit i referohet atij vetëm si “sulm i dhunshëm” ndaj Policisë së Kosovës, ndërsa brenda në raport flitet për “operacion të madh të kontrabandës së armëve”. “Krizë më serioze gjatë periudhës që përfshin raportin ndodhi më 24 shtator të vitit 2023, kur Policia e Kosovës u sulmua nga individë të armatosur rëndë, të cilët u zunë në befasi gjatë një operacioni të madh të trafikimit të armëve, duke lënë një polic të vrarë dhe tre të plagosur. Gjatë operacionit sulmuesit morën peng disa pelegjinë, duke u barrikaduar në manastirin ortodoks serb në Banjskë, të cilët i lanë pas kur u larguan”, thuhet në raport.

Raporti i bën thirrje Serbisë për bashkëpunim të plotë në hetime dhe t’i sjellë para drejtësisë përgjegjësit.

Kosova e ka fajësuar Serbinë për sulmin, duke e cilësuar atë si “tentim për ta aneksuar veriu e Kosovës”. Serbia i ka mohuar akuzat.

Përgjegjësinë për sulmin e mori Millan Radoičiq, nënkryetari i

deriatëhershëm i Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve të Kosovës, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. “Sulmi nuk duhet të shërbejë si një arsytim për cilëndo palë për largimin e vëmendjes nga dialogu i lehtësuar nga BE-ja. Kosova dhe Serbia duhet të bëjnë përpjekjet domethënëse për shtensionimin, si dhe ta sigurojnë mbajtjen e zgjedhjeve të reja në veri të Kosovës sa më shpejt që të jetë e mundur, me pjesëmarrjen aktive të serbëve të Kosovës”, thuhet në raport.

Përparimi i “kufizuar” i Kosovës

Sa iu përket përparimeve që ka arritur Kosova në fushat që i mbikëqyr Komisioni Evropian, “përparim i kufizuar” është arritur në luftën kundër korrupsionit, funksionimit të gjyqësorit, në luftën kundër krimit të organizuar dhe në lirinë e shprehjes. Në të shumtën e rasteve, raporti thekson se nuk ka pasur sa duhet rezultate në zbatim, ndonëse është arritur përparim në miratimin e kornizës ligjore.

Raporti vlerëson se Kosova ka dështuar ta reformojë administratën publike, duke nënvizuar se “nuk ka pasur përparim” në këtë fushë. Situata politike në Kosovë vlerësohet e qëndrueshme. Raporti e përmend faktin se Lëvizja Vetëvendosje gëzon një shumicë të mjaftueshme në Kuvendin e Kosovës, e cila ia ka “mundësuar ta çojë përpara një agjendë ambicioze të reformave evropiane”.

Kosova vlerësohet për reformën e ligjit zgjedhor. Tashmë si problem kronik përmendet pengimi i punës së Kuvendit të Kosovës si pasojë e mungesës së kuorumit, pavarësisht faktit se partia në pushtet ka shumicën e nevojshme në Kuvend. Problem i veçantë edhe në punën e Kuvendit, sipas raportit, është bojkoti i deputetëve serbë, të cilët shkojnë vetëm sa për t’i ruajtur mandatet, por vazhdojnë bojkotin.

Në fund të tetorit Kuvendi i Kosovës dështoi të hidhte në votim një projektzbulatë që kërkon mbështetje urgjente financiare për Policinë e Kosovës për shkak të mungesës së kuorumit.

Sa iu përket përparimeve që ka arritur Kosova në fushat që i

mbikëqyr Komisioni Evropian, “përparim i kufizuar” është arritur në luftën kundër korrupsionit, funksionimit të gjyqësorit, në luftën kundër krimit të organizuar dhe në lirinë e shprehjes. Në të shumtën e rasteve raporti thekson se nuk ka pasur sa duhet rezultate në zbatim, ndonëse është arritur përparim në miratimin e kornizës ligjore.

Raporti vlerëson se Kosova ka dështuar ta reformojë administratën publike, duke nënvizuar se “nuk ka pasur përparim” në këtë fushë.

Situata politike në Kosovë vlerësohet si e qëndrueshme, ku raporti e përmend faktin se Lëvizja Vetëvendosje gëzon një shumicë të mjaftueshme në Kuvendin e Kosovës, e cila ia ka “mundësuar ta çojë përpara një agjendë ambicioze të reformave evropiane”.

Kosova vlerësohet për reformën e ligjit zgjedhor. Tashmë si problem kronik përmendet pengimi i punës së Kuvendit të Kosovës si pasojë e mungesës së kuorumit, pavarësisht faktit se partia në pushtet ka shumicën e nevojshme në Kuvend. Problem i veçantë edhe në punën e Kuvendit, sipas raportit, është bojkoti i deputetëve serbë, të cilët shkojnë vetëm sa për t’i ruajtur mandatet, por vazhdojnë bojkotin.

Në fund të tetorit Kuvendi i Kosovës dështoi të hidhte në votim një projektzbulatë që kërkon mbështetje urgjente financiare për Policinë e Kosovës për shkak të mungesës së kuorumit.

Raporti ka dhënë disa vërejtje në fushën e lirisë së medieive. Ai përmend sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve, problemet me financim të medieive që i bën ato të ndjeshme ndaj ndikimeve të interesave politike apo financiare, dhe jotransparencën e pronësisë së medieive. Si shqetësim i veçantë në raport përmendet gjendja e lirisë së medieive në veri të Kosovës.

Dhjetëra gazetarë u sulmuan në veri të Kosovës derisa mbulonin protestat e grupeve të serbëve kundër kryetarëve të zgjedhur shqiptarë të komunave me shumicë serbe në atë zonë gjatë kësaj vere.

Asnjë rast i sulmeve ndaj gazetarëve në veri të Kosovës nuk është duke u gjykuar.

Sipas Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), 30 sulme të tilla u regjistruan në atë zonë të banuar me shumicë serbe nga 60 gjithsej sa u raportuan deri më tash këtë vit në të gjithë territorin e Kosovës.

Të mërkurën, në takimin e Kolegjit të 27 Komisionarëve, do të miratohet paketa e zgjerimit, së bashku me raportet individuale të progresit për të gjitha vendet e përfshira në procesin e zgjerimit.

Është hera e parë që raportet do të miratohen për 10 vende që janë në këtë proces. Janë gjashtë vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor - Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia - pastaj Moldavia, Gjeorgjia dhe Ukraina, ndërsa raport progresi i bëhet ende edhe Turqisë, e cila vazhdon formalisht ta ketë statusin e vendit kandidat për anëtarësim.



I DËRGUARI I POSAÇËM I BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI, MIROSSLAV LAJÇAK, KA QËNDRUAR DY DITË NË KOSOVË, PËR TË BISEDUAR PËR DRAFT-STATUTIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

Lajçaku përfundon vizitën për Asociacionin, opozita kërkon hollësi rreth draft-statutit të ri

Emisari evropian Miroslav Lajçak ka përmbyllur të martën vizitën dyditore në Kosovë, duke zhvilluar takime me përfaqësuesit e partive opozitare dhe me ambasadorët e akredituar në Kosovë, me të cilët ka biseduar për draft-statutin e ri të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Përfaqësuesi i PDK-së dhe ai i LDK-së kërkuar të dinë më shumë hollësi rreth draft-statutit dhe u ankuan se po mbahen “në terr” për shkak të mosparaqitjes së dokumentit, ndërsa lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, pretendoi se në takim opozitarëve u është paraqitur draft-statuti dhe e kanë lexuar në tërësi

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 NËNTOR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, të martën ka përmbyllur vizitën dyditore në Kosovë, duke zhvilluar takime me përfaqësuesit e partive opozitare dhe me ambasadorët e akredituar në Kosovë, me të cilët ka biseduar për draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, i cili u është paraqitur në fund të

tetorit Prishtinës dhe Beogradit. Gjatë kësaj vizite Lajçak nuk është takuar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.

Përderisa përfaqësuesit e Partisë Demokratike të Kosovës dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkuar të dinë më shumë hollësi rreth draft-statutit dhe u ankuan se po mbahen “në terr” për shkak të mosparaqitjes së dokumentit, lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës pretendoi se në takim opozitarëve u është paraqitur draft-statuti dhe e kanë lexuar

në tërësi.

Lajçaku u takua të martën kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqin, nënkryetarin e LDK-së, Lufti Haziri dhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se i dërguari i BE-së gjatë takimit përsëriti se draft-statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është në përputhje me Kushtetutën e vendit, por shtoi se “ne, fatkeqësisht, nuk patëm mundësi ta shohim përmbajtjen e tij”. “Ne kemi

nevojë t'i shohim hollësitë e tekstit [draft-statutit] për të qenë të sigurt se një themelim i Asociacionit nuk do ta ndryshojë për të keq karakterin unitar të shtetit tonë dhe nuk do ta transformojë republikën e Kosovës nga idealet e themeluesve të këtij shteti”, ka thënë ai.

Ndërkaq, nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se në takim ka përsëritur angazhimin e partisë së tij për dialogun Kosovë - Serbi, që ndërmjetësohet nga BE-ja dhe mbështetet nga Shtetet e Bashkuara. “Besoj se angazhimi i tij [Lajçakut] është për t'u vlerësuar dhe ndarja e kohës për LDK-në dhe partitë e tjera opozitare është për t'u vlerësuar, përkundër që po vazhdojmë të mbahemi, në një formë apo një tjetër, në terr për shkak të moszbardhjes së dokumentit, të mosbërjes

transparent së paku në parime dhe angazhime apo në orientime që duhet kryeministri i Republikës, si kryenegociator, t'ua ofrojë deputetëve në çfarëdo forme dhe popullit të Kosovës”, ka thënë Haziri.


Por, për dallim nga dy opozitarët e tjerë, kryetari i AAK-së, Haradinaj, tha se e “ka parë draft-statutin”. “E kemi lexuar draft [statutin] në tërësi. Ai shpjegon të gjitha mundësitë që Asociacioni ua ofron komunave me shumicë serbe, kuptohet, çdoherë duke iu referuar Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës”, ka thënë Haradinaj. Krasniqi dhe Haziri thanë se i kanë kërkuar Lajçakut që BE-ja t'ia heqë Kosovës sanksionet. BE-ja vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës në qershor për, siç tha, shpërfilljen e kërkesave për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës, ku u ngritën

Dedaj vazhdon dëshminë: Kërkova që seancat të jenë të mbyllura që të mos më rrezikohet e ardhmja dhe familja

HAGË, 7 NËNTOR - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë ka vazhduar të martën dëshminë e tij Gjergj Dedaj, i cili është dëshmitari i 33-të me radhë në çështjen gjyqësore ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Me fillimin e dëshmisë së tij, Dedaj tha se ka kërkuar që seancat të jenë të mbyllura që të mos iu rrezikohet e ardhmja dhe familja e tij. "Unë kam të drejtë të protestoj sepse unë resposible, jam përgjegjës për fatin e fëmijëve të gjeneratave, mbesave e nipave të mi dhe për këta duhet me pas konsideratë. Kam kërkuar gjatë bisedave me ju që seancat të jenë të mbyllura që të mos ma rrezikoni familjen dhe të ardhmen në Kosovë. Nëse qëllimi i kësaj gjykate është vetëm me nxjerrë çka keni dëshirë dhe të ndodhë çkado me Kosovën e na hapni plagë të reja, ajo është tjetër gjë", ka pohuar Dedaj.

Pas përfundimit të pyetjeve të Zyrës së Prokurorit të Specializuara, kundërpjetet për dëshmitarin Gjergj Dedaj i ka filluar mbrojtja e Hashim Thaçi përmes avokatit Luka Misetiç. Avokati Misetiç pyeti Gjergj Dedajin për disa persona siç është Mehmet Hajrizi. "Nuk e di



datën, por e di se disa struktura, disa individë, janë larguar nga Lidhja Demokratike e Kosovës", ka thënë Dedaj në pyetjen për Mehmet Hajrizin. Dedaj u pyet edhe për personat

si Gani Krasniqi, Gani Koci dhe Veton Surroi. "Ka pas individë që janë larguar nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Edhe ai (Gani Krasniqi), si duket, është largu nga strukturat e LDK-së. E

kam thanë dhe jam i bindur se (Gani Koci) ka dalë nga strukturat e LDK-së dhe domethënë ka kaluar në UÇK. (Veton Surroi) nuk ka qenë anëtar i LDK-së. Ai ka pasur një

lëvizje dhe ka qenë më shumë i shoqërisë civile", është shprehur Dedaj.

Brenda strukturave të LDK-së, Dedaj tha se ka pasur përçarje edhe para daljes së UÇK-së në skenë.

I pyetur nga mbrojtja e Thaçit se a kishte zyrtarë dhe politikanë që flisnin kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Dedaj ka thënë se ka pasur nga parti të ndryshme, përfshirë edhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Sipas Dedajit, individë të LDK-së kanë bërë propagandë anti-UÇK dhe kanë tentuar ta denigrojnë luftën e UÇK-së. "Individë të caktuar gjithnjë kanë bërë propagandë kundër UÇK-së duke e etiketuar me lloj-lloj etiketimesh. Kur përzihet politika në ushtri atëherë është problem. Ishin të partive të ndryshme, sepse në UÇK ka pasur anëtarë të të gjitha partive, edhe anëtarë të Partisë Liberale të Kosovës. Ka pas edhe individë, më shumë në LDK, se ka qenë partia më e madhe, që kanë bërë propagandë anti UÇK-së që kanë tentuar ta denigrojnë luftën heroike", ka thënë Dedaj.


Avokati Misetiç ka theksuar se marrja në pyetje e këtij dëshmitari nga ana e tij do të zgjasë edhe gjatë paradites së mërkurë.

Konjufca pret ambasadorin Malaj: Kosovën dhe Shqipërinë i bashkon gjithçka

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim ambasadorin e ri të Shqipërisë në Republikën e Kosovës, Petrit Malaj, me të cilin ka biseduar për zhvillimet aktuale në vendin tonë, marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy shteteve, edhe për mundësitë e thellimit e të konkretizimit të mëtejme të tyre në të gjitha fushat. Duke i uruar Malajt detyrën e re në krye të misionit diplomatik të Shqipërisë në Prishtinë, kryetari Konjufca

vlerësoi se emërimi i tij në detyrën e ambasadorit do t'i japë një shtysë të re këtij bashkëpunimi. Pasi e falënderoi ambasadorin për mbështetjen institucionale të deritanishme, Konjufca tha se Kosovën dhe Shqipërinë i bashkon gjithçka, andaj mbi këtë premisë ai shtoi se ekzistojnë mundësi të shumta të pashfrytëzuara për ta avancuar më tutje bashkëpunimin e shumanshëm. Duke e falënderuar kryetarin

Konjufca për pritjen e ngrohtë e vëllazërore, ambasadori Malaj konfirmoi përkushtimin për ta forcuar bashkëpunimin midis Tiranës dhe Prishtinës. Gjatë takimit u shkëmbyen informacione dhe ide për zhvillimet e përgjithshme në Shqipëri e Kosovë, ndërsa u vlerësua se zgjerimi i bashkëpunimit paraqet interes reciprok për të dyja vendet. Ambasadori Malaj pason në krye të misionit diplomatik të Shqipërisë në Kosovë ambasadorin e deritashëm, Qemal Minxhozi.



tensionet në fund të majit, pasi kryetarët shqiptarë u vendosën në katër komunat me shumicë serbe - pas zgjedhjeve të prillit të cilat u bojkotuan nga popullata lokale serbe.

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, pas takimit me liderët opozitarë në Prishtinë, tha se kishte një ditë "shumë produktive në Kosovë me shkëmbime të mira për zhvillimet më të fundit në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe për rrugën përpara". Lajçaku u takua një ditë më parë

edhe zëvendëskryeministrin e parë, Besnik Bislimi, me të cilin tha në një postim në rrjetin social X, se u pajtua për hapat e ardhshëm dhe për zbatimin e plotë dhe pa vonesa e parakushte të marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ndërsa Bislimi tha pas takimit se Kosova është e përkushtuar për normalizim të plotë të marrëdhënieve me Serbinë dhe për njohje reciproke.

Lajçaku erdhi në Prishtinë rreth dhjetë ditë pas takimeve të fundit në Bruksel më 26 tetor, ku Kurti

dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, u takuan ndaras me liderët e Gjermanisë, Francës dhe Italisë si dhe zyrtarë të tjerë të BE-së.

Para atyre takimeve, pesë emisarët perëndimorë në krye me Lajçakun vizituan Prishtinën dhe Beogradin më 21 tetor, ku ua prezantuan Kosovës dhe Serbisë një draft-statut për Asociacionin, për të cilin thonë se është model modern evropian, por përmbajtja e të cilit nuk është bërë publike deri më sot.

Kurti ka thënë se është i gatshëm ta pranojë dhe të nënshkruajë

draft-statutin për themelimin e Asociacionit, ndërsa presidenti serb Vuçiq e ka bërë të qartë se nuk do të pranojë asgjë që nënkupton njohjen de fakto të Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë vizitës së tij në rajonin e Dukagjinit, ka thënë se ka dërguar vërejtje për draftin e Asociacionit të paraqitur nga euro-amerikanët më 21 tetor. Ai para gazetarëve ka pohuar se drafti i modernizuar për Asociacionin është më i avancuar se marrëveshja e vitit 2013. "Për hir të konfidencialitetit të draftit,

unë nuk mund të flas për vërejtjen dhe kritikën e mia. Ato janë shumë të rëndësishme. Ia kam përcjell emisarit evropian përmes zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi më 24 tetor, dy ditë para se të takohemi në Bruksel. Ky është draft krejt tjetër pakrahasimisht më i avancuar, por kjo s'do të thotë se ne jemi të kënaqur, andaj unë kam dërguar vërejtjen", ka thënë Kurti.

Kosovës dhe Serbisë u është bërë e qartë se zbatimi i marrëveshjeve është rruga e vetme drejt integritetit në BE për të dyja vendet.

Nënshkruhen kontratat me fermerët e Skenderajt, përfitues të serrave, pulave dhe motokultivatorëve

SKENDERAJ, 7 NËNTOR - Janë nënshkruar të martën kontratat me fermerët e komunës së Skenderajt të cilët kanë përfituar serra, pula dhe motokultivatorë. Në ceremoninë e organizuar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në bashkëpunim me organizatën partnere Islamic Relief Kosova, kanë marrë

pjesë kryetari i komunës, Fadil Nura, drejtori për Bujqësi, Behxhet Maliqi, përfaqësuesit e organizatës në fjalë, anëtarët e komisionit komunal dhe të tjerë. Me këtë rast numri i përfituesve është: 25 përfitues të serrave me nga 5 ari për secilin, 71 motokultivatorë, 70 përfitues të pulave dhe 78 përfitues të serrave me nga 1

ari për secilin. Kryetari Nura, duke i përgëzuar fermerët përfitues, ka siguruar se komuna e Skenderajt do të vazhdojë të jetë përkrah fermerëve dhe bujqve nëpërmjet edhe programeve të tjera bujqësore, me qëllim të zhvillimit të sektorit më të rëndësishëm ekonomik të vendit - bujqësisë.



Shqipëria do të presë emigrantë, Italia do ta financojë strehimin e tyre

TRANË, 7 NËNTOR - Emigrantët që do të shpëtohen në Detin Mesdhe do të strehohen në Shqipëri, ndërsa Italia do të financojë për ngritjen e qendrave për pritjen e tyre. Për këtë çështje, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, nënshkroi më 6 nëntor marrëveshjen me homologen italiane, Giorgia Meloni, gjatë një vizite të paparalajmëruar në Romë.

Kryeministria e Italisë, Giorgia Meloni, në konferencën e përbashkët me kryeministrin Rama, tha se emigrantët do të zbarkojnë në Shëngjin (në bregdetin e Lezhës), më pas do të strehohen në disa zona që autoritetet do të vënë në dispozicion. "Fillimisht flasim për një numër prej 3 000 personash, ndërsa në një vit fluksi emigrator mund të mbërrijë deri në 36 000 persona. Kjo marrëveshje nuk përfshin të miturit, gratë shtatzëna dhe grupet e tjera të ndjeshme", tha Meloni.

Meloni tha se Italia do t'i mbulojë shpenzimet financiare, ndërsa sqaroi se në Shëngjin do të funksionojë një qendër që do ta bëjë regjistrimin dhe verifikimin e



emigrantëve, ndërsa foli për disa zona që Shqipëria do të ofrojë. Mediet italiane raportuan se pas verifikimit emigrantët do të

strehohen në një qendër të posaçme në Gjadër të Lezhës. Dy kryeministrat deklaruan se marrëveshja ka tri objektiva: ta

luftojë trafikimin e paligjshëm, t'i parandalojë flukset e parregullta dhe t'i mirëpresë ata që kanë vërtet të drejtën e mbrojtjes.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se e kishin diskutuar mundësinë e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje verën e këtij viti, gjatë vizitës së kryeministres italiane Giorgia Meloni në jug të Shqipërisë.

Në konferencën për medie u bë me dije se zbatimi i marrëveshjes pritet të nisë pranverën e vitit të ardhshëm. "Unë nuk besoj që ne nuk do të jemi në gjendje të paguajmë atë borxhin që kemi drejt Italisë për atë që kanë bërë për ne nga dita e parë që kemi arritur [shqiptarët] në brigjet në këtë anë të bregut të detit, për të gjetur mbështetje dhe për të pasur një jetë më të mirë. Nëse Italia thërret, Shqipëria përgjigjet", tha Rama.

Me kërkesë të Shteteve të Bashkuara, Shqipëria ka strehuar afër 2 500 iranianë, pjesëtarë të Organizatës së Muxhahedinëve të Popullit të Iranit, të cilët ndodhen në një kamp në Manzë të Durrësit. Gjithashtu, afër 2 000 afganë janë strehuar në Shqipëri, një pjesë e të cilëve janë larguar drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndërsa qindra të tjerë ndodhen ende në Shëngjin.

Hapet Panairi i Prodhimeve Vendore dhe Ushqimeve Tradicionale "Konaku i Mitrovicës 2023"



MITROVICË, 7 NËNTOR - Në komunën e Mitrovicës është organizuar Panairi i Prodhimeve Vendore dhe Ushqimeve Tradicionale. Në të janë paraqitur prodhimet e grave të vyeshme të qytetit.

Ushqime tradicionale, veshje tradicionale dhe prodhime vendore janë ekspozuar në sheshin "Adem Jashari", për qytetarët e shumtë që do ta vizitojnë këtë panair, i cili do të zgjasë katër ditë.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin kryetari i komunës, Bedri

Hamza, nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Vesa Broja, drejtorë të drejtorive komunale, asamblistë dhe qytetarë.

Hapjen e këtij panairi e ka bërë drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ferdi Kadriu, i cili i ka përgëzuar të gjitha gratë punëtore për punën e palodhshme, duke thënë se brenda dy viteve janë bërë investime mbi 1 milion euro dhe do vazhdojnë përkrahjen e sektorit të bujqësisë.

Ndërsa kryetari i komunës, Bedri Hamza, tha se zhvillimi ekonomik është ndër prioritetet kryesore të qeverisjes, dhe ne jemi të përcaktuar t'i ndihmojmë sektorit privat përmes investimeve publike dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë. "Me bindje të plotë dhe vendosmëri them që përmes drejtorive përkatëse do ta shumëfishojmë përkrahjen për prodhuesit që promovojnë produkte vendore dhe tradicionale", është shprehur Hamza.

Në Prishtinë vazhdon zbatimi i planeve operative për ngritjen e sigurisë në trafik

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Policia e Rajonit të Prishtinës, respektivisht Njësi Rajonal i Trafikut Rrugor, krahas

planeve operative për kontrollin e shtuar në trafik, me 06.11.2023 ka filluar zbatimin e planit për kontroll

ndaj ngasësve të automjeteve për bartjen e udhëtarëve dhe mallrave, sipas programit evropian Roadpol. Ky

operacion do të ketë shtrirje në të gjitha rrugët e rajonit të Prishtinës. Vetëm të hënën janë gjobitur 12 kundërvajtës.



KMDLNj: Regjistrimi i veturave falas për qytetarët e veriut, diskriminim në baza etnike

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka thënë se është duke vazhduar diskriminimi i qytetarëve të Kosovës në baza etnike me ofertën e fundit për regjistrim të veturave me targa RKS me lehtësime financiare vetëm për qytetarët e veriut. "MPB-ja e Kosovës ditëve të fundit bombardoi qytetarët e vendit me SMS në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze me të cilin fton qytetarët që deri me datën 1.12.2023 të regjistrojnë veturat me targa RKS, me lehtësira financiare (gratis) sipas një vendimi të qeverisë. Kjo ofertë gjeneroze, e motivuar

politikisht dhe etnikisht thellësisht diskriminuese, e kundërligjshme dhe kundër të drejtave elementare të njeriut vlen vetëm për komunat e veriut, komunat e Asociacionit që kanë refuzuar targa RKS që nga përfundimi i luftës e deri më sot", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Sipas këtij institucioni, qytetarët e tjerë të Kosovës detyrohen t'i regjistrojnë veturat me tarifa financiare në shpërputhje me gjendjen e tyre ekonomike dhe çdo vonesë penalizohet nga autoritetet përgjegjëse. "Në gjerdanin e diskriminimit të qytetarëve të Kosovës,

ekskluzivisht sipas parimit politik dhe etnik siç ishte pagesa nga buxheti i shtetit të rrymës, ujit, mbeturinave, tatimit në pronë dhe tatimeve tjera, rrogat për Rojat e Urës dhe strukturat tjera të kundërligjshme, pa e bërë as edhe një ditë të vetme të punës po i shtohet edhe regjistrimi i veturave me targa RKS për kategorinë e qytetarëve jointegruer të veriut të Kosovës të cilët, që nga përfundimi i luftës kanë refuzuar të paguajnë rrymën, ujin, mbeturinat, tatimin madje, jo rrallë duke e kundërshtuar dhunshëm institucionet e shtetit të Kosovës", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.



Kosova dhe Turqia zotohen për forcim të marrëdhënieve në politikën e jashtme

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme i Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë, Fuat Oktay, po qëndron për vizitë në Kosovë. Ai është pritur të martën në takim nga kryeparlamentari Glauk Konjufca. Në takim u diskutua për çështje të rëndësishme të interesit të përbashkët, bashkëpunimin ndërparlamentar, ekonomik e tregtar dhe në fushën e politikës së jashtme, si dhe u këmbyen pikëpamje rreth zhvillimeve të fundit rajonale dhe aktualiteteve në skenën ndërkombëtare. Po

ashtu, biseda u fokusua në marrëdhëniet e veçanta dhe miqësore, që karakterizojnë dy vendet tona, dhe u shpreh vullneti i dyanshëm për t'i shtuar ato në të gjitha fushat e mundshme të bashkëpunimit. Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme i parlamentit turk, i cili deri para pak muajsh ka shërbyer zëvendëspresident i Turqisë, Fuat Oktay, e falënderoi kryetarin Konjufca për pritjen dhe rithëksoi gatishmërinë për fuqizimin e raporteve të ndërsjella, si dhe vazhdimin e mbështetjes së shtetit të tij ndaj Republikës së Kosovës. Ndërkaq Konjufca vlerësoi lart

dhe shprehu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Turqia i ka dhënë Kosovës para dhe gjatë luftës, si dhe gjatë procesit të shtetformimit, shtetndërtimit dhe anëtarësimit në institucione dhe organizata ndërkombëtare. Njëherësh e njoftoi Oktayn në lidhje me punën dhe prioritetet e legjislativit, zhvillimin e gjithëmbarshtëm dhe sfidat e shtetit tonë në rrugëtimin integruer. Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Madh Kombëtar të Turqisë, i prirë nga kryetari Fuat Oktay, u prit në takim edhe nga Komisioni për Punë të Jashtme

dhe Diasporë i Kuvendit të Kosovës. Në këtë takim, kryesuar nga kryetarja e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, u vunë në dukje raportet shumë miqësore ndërmjet dy vendeve dhe gatishmëria për thellimin e mëtejshme të tyre. Me këtë rast, kryetarja e Komisionit, Kryeziu-Hyseni, nënvizoi fushat e bashkëpunimit me interes për të dy vendet, ndërkaq kërkoi përkrahje edhe më të madhe në mënyrë që Kosova të arrijë anëtarësimin në të gjitha organizatat ndërkombëtare. Mysafirët nga Turqia i

përsëndeti dhe u uroi mirëseardhje edhe nënkryetari i Komisionit, Xhavit Haliti, i cili, po ashtu, foli për raportet ndërmjet dy vendeve dhe kujtoi ndihmën e ofruar nga Turqia për vendin tonë. Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme i Kuvendit të Madh Kombëtar të Turqisë, Fuat Oktay, pasi i përsëndeti nikoqirët dhe i falënderoi për pritjen e ngrohtë, foli për angazhimet e së ardhmes. Ai vlerësoi se takimet si ky i sotmi duhet të vijojnë, ndërkaq u shpreh se ndihma për Kosovën do të jetë e pakursyer në të gjitha fushat.

Pezullohet protesta e paralajmëruar nga pjesëtarët e njësive elitare, Kurti premtonte zgjidhje

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Njësia Speciale Intervenuese (NJSI), Njësia për Trajtimin e Mjeteve Eksplozive (NJTME) dhe njësi të tjera të Policisë së Kosovës kishin paralajmëruar mbajtjen e protestës për të martën në orën 12:00 në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, por ajo është pezulluar. "Pas takimit të drejtorit të Përgjithshëm të PK-së me NJSI

dhe NJTME është marrë vendim që të pezullohet përkohësisht protesta e paralajmëruar për sot 07.11.2023 në orën 12:00. Deri te pezullimi i protestës ka ardhur pasi drejtori i Përgjithshëm i PK-së, i shoqëruar nga menaxhmenti i PK-së, gjatë takimit me këto njësi, i ka informuar se kryeministri i Republikës së Kosovës ka

premtuar që javën e ardhshme do t'i presë në takim zyrtar menaxhmentin e PK-së së bashku me përfaqësuesit e këtyre njësive, për t'i diskutuar kërkesat e tyre, respektivisht për të gjetur një zgjidhje", ka njoftuar Policia e Kosovës, duke theksuar se protesta e paralajmëruar do të pezullohet deri në një vendim tjetër.



Punëtorët e KEK-ut marrin premtim për ngritjen e pagave

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Sindikata e KEK-ut ka dhënë hollësi lidhur me anulimin e protestës e cila ishte paralajmëruar për të martën, duke thënë se janë pajtuar me menaxhmentin dhe bordin e kësaj ndërmarrje që gjatë muajve nëntor dhe dhjetor do të jenë në negociata për ngritjen e pagës, në të kundërtën kanë paralajmëruar vazhdimin e veprimeve sindikale.

Kryetari i Sindikatës së Korporatës Energjetike të Kosovës, Nexhat Llumnica, në një intervistë për "KosovaPress", ka konfirmuar se protesta është shtyrë pasi që kanë marrë zotim se kërkesat e tyre do të plotësohen gjatë muajve në vazhdim. Llumnica tha se kërkesa kryesore e tyre është ngritja e pagave të punëtorëve të KEK-ut, dhe nëse deri në dhjetor nuk plotësohet kjo kërkesë, ai

tha se do të vazhdojnë protestat. "Kërkesat tona, d.m.th të Sindikatës, janë të shumta, mirëpo një ndër to ka qenë rritja e pagave. Dje kemi biseduar me kryesuesin e bordit dhe menaxhmentin e KEK-ut. Ata janë zotuar që gjatë muajit nëntor dhe dhjetor do të jemi në dialog në vazhdimësi dhe do të negociojmë për ngritjen e pagave dhe për kërkesat e tjera", ka thënë Llumnica.



Paratë e falsifikuara, deklaratë e institucioneve: Qytetarët ta shmangin përdorimin e dy eurove, t'i shfrytëzojnë kartelat bankare

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në bashkërendim me Policinë e Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, Doganat e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës, Njësinë e Intelgjencës Financiare, Inspektoratin e Tregut dhe Agjencinë e Kosovës për Intelgjencë kanë mbajtur sot një takim lidhur me veprimet institucionale për luftimin e parave të falsifikuara që po qarkullojnë në Kosovë.

Në takim palët diskutuan për situatën aktuale që lidhet me fenomenin e parave të falsifikuara që po qarkullojnë në Republikën e Kosovës si dhe shkëmbyen informacione mbi burimet dhe origjinën e monedhave të falsifikuara dhe valutave të hasura në treg. "Mbi bazën e këtyre diskutimeve palët u dakorduan për një plan të veprimit, i cili parasheh ndërmarrjen e veprimeve parandaluese dhe rregullative nga institucionet sipas fushave të përgjegjësisë lidhur me përdorimin e monedhave dhe rritjen e mbrojtjes financiare. Në zbatim



të këtij plani, parashihet edhe rishikimi i tarifës së depozitimit të monedhave në banka nga BQK, avancimi i bashkëpunimit

ndërinstitucional dhe sektorit financiar, si dhe promovimi i përdorimit të mënyrave elektronike të pagesave, si pjesë e

fushatave të edukimit financiar", thuhet në njoftim. Po ashtu, rekomandohet që bizneset të furnizohen vetëm nga

bankat me para të gatshme të cilat furnizohen nga BQK-ja, kurse mjetet e pranura t'i nënshtrohen verifikimit para se të njëjtat të rivihen në qarkullim. Po ashtu, me theks të veçantë udhëzohen qytetarët ta shmangin përdorimin e parave të gatshme (veçanërisht monedhën 2 euro) dhe të shfrytëzojnë sa më shumë kartelat bankare gjatë pagesave. "Veprime konkrete kërkohen edhe nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, që të ngritin kapacitetet e brendshme të adresimit të kësaj dukurie dhe komunikimit sa më efikas me autoritetet përkatëse. Palët u pajtuan të intensifikojnë aktivitetet në zbatim të ligjit, të shtohen kontrollet dhe aktivitetet inspektuese brenda dhe në kufi, si dhe të ndiqen ligjërisht dhe me efikasitet aktivitetet e tilla joligjore, të dënueshme sipas legjislacionit në fuqi. Në fund të takimit, palët u dakorduan që përmes grupit punues ndërinstitucional, të koordinohen aktivitetet sipas fushëveprimit përkatës të institucioneve, të rekomandojnë ndryshimet legjislative dhe monitorojnë në vazhdimësi zbatimin e këtij plani", thuhet në njoftim.

Komunat grumbullojnë 42.3 milionë euro nga të hyrat e tatimit në pronë

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Komunat kanë shënuar rritje të të hyrave në pronë me miliona euro në krahasim me vitin e kaluar. Ndonëse nuk ka përfunduar ende ky vit, komunat kanë arritur t'i grumbullojnë të hyrat nga tatimi në pronë në vlerë mbi 42 milionë euro, ose rreth 95 për qind të të hyrave, nga 44.5 milionë sa është e paraparë. Edhe falja e cila është paraparë në Ligjin për Tatimin në Pronë, e që është në Gjykatë Kushtetuese, nuk ka nevojë të ndodhë. Kështu thotë drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan

Ibrahimi. Ibrahimi në një intervistë për "KosovaPress" thekson se gatishmëria e qytetarëve të paguajnë tatimin në pronë ka qenë jashtëzakonisht e madhe. Sipas tij, edhe pse janë hequr disa kushtëzime në këtë drejtim, nuk ka munguar gatishmëria e qytetarëve që ta paguajnë tatimin. "Nga shuma totale e cila është e planifikuar për vitin 2023 që komunat t'i mbledhin nga tatimi në pronë, e që është e hyra kryesore e komunës, ka qenë e planifikuar që komunat të mbledhin rreth 44.5 milionë euro. Deri në ditët

e fundit komunat kanë arritur t'i grumbullojnë të hyrat nga tatimi në pronë në vlerë prej 42.3 milionë eurosh, që në përqindje i bie rreth 95 për qind të të hyrave vetjake nga tatimi në pronë. Pra, është bërë një punë e mrekullueshme nga autoritetet lokale në grumbullimin e të hyrave vetjake nga tatimi në pronë, gjithashtu po shihet se gatishmëria e qytetarëve është ta paguajnë tatimin në pronë edhe pse të gjitha kushtet sa i përket pagesës së tatimit në pronë janë larguar", është shprehur Ibrahimi.



Trumbetari Zorzi që interpretoi para Skënderbeut!

Nga: Matteo Mandalà (titulli original: Skënderbeu dhe muzika flamande: disa shënime mbi trumbetarin Zorzi)

Disa kohë më parë, në një post që botova në mediat sociale, përmenda një koncert muzikor që ishte ekzekutuar në prani të Skënderbeut. Këtë të dhënë e pata nga kolegu dhe miku Ivano Cavallini, muzikolog i njohur, që është marrë shpesh me heroin kombëtar të shqiptarëve. Cavallini ka pranuar të marrë pjesë në një konferencë shkencore, organizuar nga Katedra e Albanologjisë e Universitetit të Palermos në kuadrin e kursit të doktoratës për Kulturën Pamore, që do të mbahet në dhjetor me temën: Skënderbeu në Fushat e Elisit. Receptimi multimedial i një heroi të epokës së Humanizmit. Aty do të trajtohet figura e personazhit historik, por edhe reflekset e tij mitike, letrare dhe artistike falë kontributeve të disa studiuesve (Lucia Nadin, Francesco Altimari, Aurel Plasari, Ferid Hudhri, Nicola Scaldaferrì, Gëzim Gurga), por edhe të Edi Ramës që do të marrë pjesë si artist. Me këtë rast e shoh me vend ta rimarr shënimin e dikurshëm dhe ta shtjelloj më mirë për lexuesit e ExLibris-it.

Në një artikull të botuar në vitin 1981, muzikologu anglez Daniel Leech-Wilkinson analizoi dorëshkrimin Cotton Titus A. XXVI që sot gjendet në Bibliotekën Britanike (British Library), por që më parë ruhej në bibliotekën private të sir Robert Cottonit (1571-1631).[1] Ky dorëshkrim u hartua mes viteve 1444-1449 nga trumbetari Zorzi, emri i të cilit shfaqet në fletën e parë (fl. 2r: in nomine domini 1444 se fatto questo libro per zorzi t(rom)beta da modon). Zorzi ishte një venedikas (ose me gjasa grek i venetizuar) i lindur në Methoni (it. Modone), qytetë bregdetare e Peloponezit, që bashkë me Koronën përbënin dy zotërimi strategjike për rrugët e tregtisë detare të Venedikut të cilat, sipas historianit Alain Ducellier, mbaheshin si "syri i djathtë i Republikës". Prej kohësh Zorzi shërbente si muzikant nëpër anijet veneciane që lundronin në ujërat e Adriatikut.

Në këtë dokument, historia e shkrimit të të cilit shtron një sërë problemesh filologjike që kanë të bëjnë me ductus-in, pra me grafitet e ndryshme që përmban, me ngjyrat e bojës së shkrimit, me lidhjen anormale të fashikujve, veç të tjerash gjenden edhe një sërë shënimesh të përgjithshme me interes historik mbi shfaqjet artistike që kreu trumbetari gjatë lundrimit.

Zorzi në këtë dorëshkrim, që përmbante disa pjesë të shkruara

nga autorë të tjerë anonimë, kopjoi apo shkroi disa poezi italisht dhe latinisht, lutje, nocione të mjekësisë, shënime të përditshme, epigrame morale, llogari shpenzimesh mbi të cilat do të ndalemi më poshtë, si edhe disa shënime mbi ndërtime e velave dhe të anijeve. Rëndësi të veçantë paraqesin shënime muzikore, paçka se ndonjëherë të pasakta dhe të paplota, që me gjasa ishin vetëm për përdorim vetjak, tekstet e nëntë kompozimeve rondeaux të kompozitorëve franko-flamandë të kohës. Bëhet fjalë për krijime të përbëra nga 2-3 pjesë për t'u kënduar në frëngjisht, të cilat sipas zakonit të atëhershëm, në raste solemne mund të shoqëroheshin edhe me muzikë instrumentale. Nga titujt që po i sjellim këtu poshtë ashtu siç janë shkruar nga vetë Zorzi:

Jour a jour la vie (f. 3v),

Qu'en puis je mais (f. 4r),

Une fois avant que mourir (f. 4v),

Tenor d'una balattina francese (f. 5r),


Je me recomande (f. 5v),

Puische m'amour m'a pris (f. 6r-v),

En ce prumttemps souentt mes pas (dy variante), (f. 7r-v),

Puische m'amour gie se far danser le dames (f. 8r).

Por, sidomos nga vendndodhja e teksteve, muzikologët kanë nxjerrë në pah një dëshmi të jashtëzakonshme që na lejon të rindërtojmë sot kontekstin historiko-artistik, si edhe përhapjen e këtyre krijimeve rondeaux. Heinrich Bessler[2] u ka kushtuar këtyre teksteve disa studime të rëndësishme historiko-muzikore ku parashtron një sërë vëzhgimesh kritike me vlerë të madhe muzikologjike dhe filologjike, të cilat së bashku kontribuojnë në rindërtimin e suazës së qarkullimit të muzikës dhe sidomos të ndryshimeve që pësonin tekstet dhe partiturat kur kopjoheshin nga një dorëshkrim te tjetri. Për të pasur një ide të përgjithshme të pasurisë e të kompleksitetit të teksteve gjatë procesit të përcimit dorëshkrimor, duhen lexuar studimet e kodotike dhe muzikologjike të Leech-Wilkinsonit, i cili, në hullinë e kontributeve pararendëse që H. Bessler, P. Möller, W. H. Kemp dhe sidomos H. Schoop u kushtuan dorëshkrimeve të ngjashme me atë të Cotton Titus A. XXVI, erdhi në përfundimin, paçka se hipotetik ("të përkohshëm" shkruan muzikologu anglez), se "priremi [...] t'i konsiderojmë këto pesë burime si një grup dorëshkrimesh të lidhura mes tyre, që vijnë nga Venediku rreth viteve 1420-1430". Këto përfundime na lejojnë të rindërtojmë profilin "artistik" të trumbetarit Zorzi, si edhe të qëmtojmë lidhjet e thella me traditën muzikore të kohës së tij: muzikanti i Methonisë jo vetëm



që i njihje mirë traditat e kohës së tij historike, por i interpretonte ato sipas shijes dhe mënyrës së vet subjektive. Këtë vlerësim e konfirmojnë punimet e ndryshme që Rodolfo Baroncini i ka kushtuar Zorzit, sidomos studimi i vitit 2002,[3] ku rindërtohet profili biografik dhe artistik i trumbetarit tonë.

Zorzi ishte pajtuar për të luajtur në një anije "chapetagna", pra në një galerë të madhe, dhe punonte në ortakëri me njëfarë Girardo, edhe ai muzikant, dhe me fyelltarin Borttolamio, që me gjasa kishte qenë nxënës i një muzikanti nga Poreçi (në Istria). Asokohe ishte zakon që të përdorehin vegla të ndryshme muzikore për të paralajmëruar lëvizjet e anijeve ne det dhe pranë porteve. Përbërja e muzikantëve që kryenin këtë punë ndryshonte sipas llojit të anijes: për shembull, "anijet e përmasave të vogla përdornin dy trumbeta; ato me tonazh të madh kishin një trumbetë, një tambur dhe dy timpane".[4] Natyrisht, grupi i muzikantëve mund të ndryshonte sipas numrit të anëtarëve dhe llojit të veglave dhe, siç shënon Leech-Wilkinson, "një pjesë të kohës së tyre në udhëtime të gjata, ka të ngjarë që ata (muzikantët) të argëtonin edhe oficerët dhe ekuipazhin, nëse do të kishin përgatitje të mjaftueshme muzikore". Përveç veprimtarisë kryesore që zëmë ngoje më lart, muzikantët përpiquehin të shtonin fitimet duke u marrë me tregti dhe me veprimtari të tjera: kështu për shembull, dimë se Zorzi jo vetëm që shiste verë kur gjente rast, por gjatë ndalimeve në portet e Arbërisë venedike, së bashku me shokët muzikantë organizonte shfaqje muzikore me kërkesën e të parëve të vendit. Këtë e dimë me siguri sepse Zorzi shënonte me përpikëri në një ditar të gjitha fitimet shtesë për çdo lloj pune që

kryente a malli që shiste. Pikërisht në një nga këto shënime gjendet edhe një njoftim me vlerë të jashtëzakonshme.

Mes viteve 1448 dhe 1449, galera ku gjendej Zorzi lundroi përgjatë bregut lindor të Adriatikut, duke ndaluar në portet Zarë, Traù, Budvë, Dubrovnik, Kotor, Lezhë, Korfuz, Patras dhe Lepanto, pra në ato brigje të Dalmacisë, të Malit të Zi, të Shqipërisë dhe të Greqisë që asokohe gjendeshin nën sundimin e Venedikut. Disa dokumente përmbajnë pagesa për shfaqje muzikore në raste festash a dasmash nëpër qytetet e lartpërmendura ku qëndronte anija, me ftesën e bujarëve të vendit.

Në prill të vitit 1449, me gjasa i shoqëruar nga muzikantë të tjerë, Zorzi u ftua të luante në Lezhë nga Skënderbeu ("Scanderbecho"), prej të cilit mori si shpërblim një shumë parash më të lartë se në raste të tjera, siç rezulton nga shënimi i ditës 17 prill: 10 lira dhe 10 solde (shih f. 25v të dshk. Cotton Titus A. XXVI dhe transkriptimin e tekstit te f. 36 të artikullit të cituar të Leech-Wilkinson që sjell listën e plotë të llogarive). Ende sot e gjithë ditën historianët e Venedikut dhe muzikologët nuk e kanë vënë re përkimin onomastik mes trajtës popullore veneciane "Scanderbecho" dhe emrit të Skënderbeut. Në fakt nuk ka asnjë dyshim se "Schanderbecho" i përmendur nga Zorzi është Gjergj Kastrioti ynë, sikurse nuk ka dyshim se vendi ku u zhvillua shfaqja e muzikantëve ishte qyteti bregdetar i Lezhës. Në bazë të shpërblimit të paguar, mund të themi se Kastrioti do të ketë mbetur vërtet i kënaqur nga shfaqja e grupit të drejtuar prej Zorzit, çka tregon se heroi i ardhshëm i shqiptarëve, pak vite pas braktisjes së oborrit të Sulltanit, dëshmonte se kishte

shije muzikore të njëjta me fisnikërinë e Francës, të Italisë, të Belgjikës dhe të vendeve të Evropës Qendrore, ku ajo lloj muzike ishte në modë ndër familjet aristokratike më të rafinuara. Ky fakt rihap çështjen e formimit që kishte marrë Skënderbeu gjatë periudhës së qëndrimit në Turqi si peng i Sulltan Muratit II. Me siguri nuk do të ketë qenë një formim i njëkahshëm dhe kryekëput lindor, përderisa Kastrioti dëshmoi interes për modat perëndimore. Kjo arsye e fundit e bën edhe më të rëndësishëm faktin që Kryezoti i Arbrit ka pajtuar tre muzikantë për të luajtur një lloj muzike të panjohur për kulturën osmane. Nuk mund të përjashtohet ta ketë bërë këtë jo vetëm për të dëfryer mysafirët e rastit nga Evropa perëndimore, por edhe për kënaqësinë e vet, çka na ndihmon ta njohim më mirë profilin kulturor të heroi kombëtar të shqiptarëve.

/Gazeta "ExLibris"/

[1] Shih Daniel Leech-Wilkinson, *Il libro di appunti di un suonatore di tromba del quindicesimo secolo, në Rivista Italiana di Musicologia*, XVI, 1981, f. 16-39.

[2] Heinrich Bessler, *Studien zur Musik des Mittelalters. I. Neue Quellen des 14. und beginnenden 15. Jahrhunderts në Archiv für Musikwissenschaft*, 7. Jahrg., H. 2. (Jun., 1925), f. 167-252.

[3] Shih R. Baroncini, *Zorzi trombetta e il complesso di piffari e tromboni della Serenissima. Per una storia 'qualitativa' della musica strumentale del XV secolo, në Studi Musicali*, XXXI, 2002, f. 57-87.

[4] Althea Wiel, *The navy of Venice, E. P. Dutton and Company, New York, 1910, f. 324.*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Trepça nuk luan me Hapoel Galil, izraelitët tërhiqen nga garat

MITROVICË, 7 NËNTOR - KB Trepça nuk do të luajë me izraelitët e Hapoel Galil Elion në fazën grupore të FIBA Europe Cup. Hapoeli është tërhequr nga kjo garë. Është FIBA që i ka larguar nga faqja zyrtare e FIBA Europe Cup dhe ka fshirë ndeshjet e planifikuara të skuadrave izraelite. Për shkak

të situatës në Lindjen e Mesme, FIBA kishte vendosur që ndeshjet e skuadrave izraelite të zhvillohen në Qipro, por këto ekipe nuk ishin pajtuar me të gjitha kushtet e FIBA-s dhe vendosën të tërhiqen edhe zyrtarisht. Tashmë në Grupin G do të jenë vetëm tri ekipe. Trepça nga

Kosova, Leideni i Holandës dhe Gravelines i Francës. "Xehetarët" deri më tani i kanë zhvilluar dy ndeshje, duke u përballur nga njëherë me Leidenin dhe Gravelines. Me të dy këto ekipe ka pësuar humbje të thella. Fillimisht në shtëpi pësoi nga Leideni me minus 30 pikë, 54:84, e më pas

javën e kaluar në Francë nga Gravelines 83:49. Ndeshjen e radhës Trepça e zhvillon në Holandë ndaj Leidenit më 15 nëntor, derisa më 22 nëntor e pret skuadrën franceze të Gravelines në "Minatori". Kjo është hera e parë që "Xehetarët" janë pjesëmarrës të grupeve në FIBA Europe



Cup. Në këtë fazë mitrovicasit erdhën pasi arritën triumfin ndaj Tindastollin dhe Parnun, takime që u mbajtën në Estoni.

Ndeshja Kosovë - Izrael do të zhvillohet me tifozë

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Njëzet e tetë ditë pas planit fillestar, 22 futbollistë të Kosovës dhe Izraelit do të shkelin në fushën e gjelbër të stadiumit "Fadil Vokrri" në Prishtinë më 12 nëntor. Në përkrahje të tyre do të jenë edhe rreth 14 mijë tifozë - nëse shiten të gjitha biletat. Se ndeshja do të zhvillohet me praninë e tifozëve e konfirmoi për Radion Evropa e Lirë presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi. "Pas mbledhjes me UEFA-n [Federatën Evropiane të Futbollit], është marrë vendimi që ndeshja të zhvillohet me tifozë", ka thënë Ademi. Ai ka shtuar se do të merren të gjitha masat e parashikuara me rregulloret e UEFA-s, që ndeshja të mos përcillet me ndonjë incident të mundshëm. Mundësia që ndeshja të zhvillohej pa praninë e tifozëve u përfol në rrjetet sociale, pasi që Kosova - vend me shumicë myslimane - do të mund të gjobitej dhe ndëshkohej nga UEFA, nëse në stadium do të ndodhte ndonjë incident, shkak i luftës mes Izraelit

dhe Hamasit - grupit militant që kontrollon Rripin e Gazës. Në Kosovë u organizuan disa marshe në mbështetje të palestinezëve në Gazë, ndërsa u nderuan edhe viktimat në Izrael. Ndeshja e 12 nëntorit - në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian të vitit 2024 - fillimisht ishte planifikuar të zhvillohej më 15 tetor. Por, ajo ishte shtyrë shkak i luftës në Lindjen e Mesme. Personave që kishin blerë biletat për ta parë ndeshjen mes Kosovës dhe Izraelit u ishin kthyer paratë pak ditë pas shtyrjes. Por, presidenti i FFK-së tha për REL-in se biletat do të dalin sërish në shitje "brenda një ose dy orësh". Ademi tha se i takon Policisë së Kosovës t'i marrë masat e duhura të sigurisë në mënyrë që të mos lejohet ndonjë incident. Policia e Kosovës dhe UEFA nuk u përgjigjën në pyetjet e REL-it lidhur me masat e sigurisë që do të ndërmerren. Ndërkohë, ambasadorja izraelite në Kosovë, Tamar Ziv, u shpreh e kënaqur me,



siç tha, koordinimin e bërë deri më tani me autoritetet e Kosovës për "realizimin e suksesshëm të ndeshjes". "Ne jemi duke punuar në koordinim të ngushtë me të gjitha autoritetet relevante në Kosovë për çështjet e sigurisë së ndeshjes dhe për mirëqenien e lojtarëve tonë", tha ajo për Radion Evropa e Lirë. Ndeshja në "Fadil Vokrri" do të jetë ndeshja e parë për Kombëtaren e Izraelit që nga shpërthimi i luftës mes Izraelit dhe Hamasit. Grupit militant, i shpallur terrorist nga SHBA-ja dhe disa fuqi të tjera, ka

sulmuar Izraelin më 7 tetor, duke vrarë mbi 1.400 njerëz dhe duke marrë pengje 239 të tjerë. Izraeli është përgjigjur me një fushatë masive të sulmeve ajrore në Rripin e Gazës. Numri i palestinezëve të vrarë në këtë enklavë ka tejkaluar tashmë shifrën 10.000, sipas Ministrisë së Shëndetësisë atje. Ngjarjet e tilla kanë shkaktuar protesta në vende të ndryshme në botë, përfshirë edhe Kosovën. Deri më tani janë zhvilluar dy protesta në përkrahje të palestinezëve në Prishtinë dhe një tjetër në Prizren.

Çka nëse në stadium shfaqen mesazhe politike?

Rregulloret e UEFA-s përcaktojnë që për mbarëvajtjen e kësaj ndeshjeje, përgjegjëse do të ishte Federata e Futbollit të Kosovës. Në rast të ndonjë incidenti me mesazhe politike të shfaqura në tribuna, për të do të ndëshkohej Kosova.

Rregulloret e UEFA-s përcaktojnë që për shfaqjen e mesazheve politike dhe atyre raciste, dënimet mund të nisin nga një gjobë e deri te ulja e pikëve dhe përjashtimi nga një garë. Kështu ka ndodhur tashmë me Rumaninë. Federata rumune është gjobitur me 52 mijë euro dhe është dënua me një ndeshje pa tifozë nga UEFA, pasi që në ndeshjen kundër Kosovës më 12 shtator është shpalosur një pankartë me mesazhin "Kosova është Serbi", si dhe janë dëgjuar thirrje raciste.

Favre vizitë në Kosovë, lavdëron punën e bërë nga FFK-ja

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Zëvendësudrejtori i Federatave anëtare të UEFA-s, Thierry Favre, nga dita e hënë po qëndron për vizitë në Prishtinë. Ai ka ardhur për vizitë në Federatën e Futbollit të Kosovës, me ç'rast është pritur nga presidenti Agim Ademi, u.d./sekretari i përgjithshëm Marcus Weidner dhe drejtues departamentesh në FFK. Gjatë vizitës së tij në shtëpinë e futbollit në Kosovë si dhe në Kampin Nacional në Hajvali, Favre shprehu kënaqësinë e tij për zhvillimin e



futbollit këtu, siç janë infrastruktura, edukimi, organizimi i garave,

referimi e sidomos pati lëvdata për ecurinë e futbollit të femrave. "Jam i

lumtur që më në fund u ktheva në Kosovë pas tri vjetësh. Më intereson edhe më shumë të kthehem këtu pasi të finalizohet projekti në Kampin Nacional në Hajvali. Gjithmonë kam besuar se është thelbësore për zhvillimin e futbollit në këtë vend të kesh kushte të mira për të stërvitur", ka shtuar Favre. Më tutje zëvendësudrejtori i federatave anëtare të UEFA-së tha se duhet pasur durim dhe jo eufori për rezultat në ekipet përfaqësuese, derisa shprehu bindjen e tij se shumë shpejt Kosova do të jetë në

njërin nga ngjarjet e mëdha dhe në çastin kur kjo të ndodhë atëherë do të vazhdojë të kualifikohet edhe shumë herë të tjera. Ndërkaq, presidenti Ademi u shpreh i lumtur për vizitën e Thierry Favre, për vlerësimin dhe inkurajimin e tij për futbollin e Kosovës.

Kujtojmë që Favre është ndër zyrtarët e parë të UEFA-s i cili, pas pranimit të Kosovës në dy institucionet e futbollit, UEFA e FIFA, ka vizituar Kosovën dhe ka udhëhequr projektet e FFK-së për infrastrukturë dhe zhvillim.

Peja në kërkim të fitores së tretë radhazi në FIBA Europe Cup

Pejë, 7 nëntor - Peja në top formë në garat vendore dhe ndërkombëtare. Skuadra verdhezi ka shtatë fitore në shtatë ndeshje në Prince Caffë Superligë, kurse në FIBA Europe Cup ka dy fitore radhazi. Humbjen e vetme e ka nga NINERS Chemnitz dhe pikërisht ndaj skuadrës

gjermane do të luajë nesër (e mërkurë) në Karagaçi nga ora 19:00. Takimin e parë e kishin fituar gjermanët 98:72, ndërsa më pas pejanët fituan kundër Heroes Den Bosch me rezultat 99:84 dhe në udhëtim ndaj PGE Spojnia Stargard 79:83. NINERS Chemnitz është lider me tri

fitore, Peja ka dy fitore e një humbje, PGE Spojnia Stargard një fitore e dy humbje, ndërsa Heroes Den Bosch e fundit me tri humbje. Peja ka kërkuar mbështetjen nga publiku për atmosferë të jashtëzakonshme dhe për t'u dhënë kurajë

basketbollistëve në këtë përballje shumë të rëndësishme. Këtë mesjavë është dashur të luajë edhe Trepça në grupet e FIBA Europe Cup, por takimi ndaj Hapoel Galil Elion nuk do të zhvillohet, pasi skuadra izraelite nuk ka zhvilluar asnjë sfidë deri më tani për



shkak të situatës në Izrael dhe të gjitha sfidat e skuadrës izraelite janë pezulluar.

Pjesëtarët e FKS-së përfunduan me sukses trajnimin në xhudo

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Një vjet nga inicimi i marrëveshjes me Federatën e Xhudos, në kuadër të programit "Kosova, shtet i xhudos", pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës përfunduan me sukses

trajnimin në këtë sport, me udhëheqjen e kryetrajnerit Driton Kuka dhe xhudistëve elitare të Kosovës. Në trajnim pjesëtarët e FSK-së kanë përvetësuar aftësitë e vetëmbrojtjes, teknikave të

xhudos dhe luftës së afërt. Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë kryeministri Albin Kurti, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku. Ministri

Maqedonci u shpreh se certifikimi i grupit të parë është moment historik, i jashtëzakonshëm, që mishëron frymën e unitetit, përkushtimit dhe vizionit të përbashkët për rritjen e shtetit tonë.



Messi: Doja ta mbyllja karrierën te Barça, por ishte e pamundur

PARIS, 7 NËNTOR - Lionel Messi ka dhënë intervistë për revistën "France Football". Ai ka treguar për suksesin e tij më të fundit, "Topin e Artë", të tetin në karrierën e tij. Pas kurorëzimit si lojtari më i mirë në planet, "pleshti" ka bërë një përmbledhje të karrierës së tij, Botërorin në Katar dhe raportet e tij me Barcelonën e kthimin e munguar te katalanasit. "Mund të isha kthyer te Barcelona dhe ta mbyllja karrierën atje, por nuk ndodhi. Ishte një situatë e ngjashme me atë në vitin 2021 kur u largova nga klubi. Ideja ime e parë ishte e qartë: të kthehesha në shtëpi, të kthehesha të luaja për Barcelonën dhe ta mbyllja karrierën me këtë ekip siç gjithnjë kisha ëndërruar. Por, fatkeqësisht, nuk qe e mundur", ka deklaruar Messi. Pavarësisht prej kthimit të pamundur, argjentinasi ka deklaruar se sheh ndeshjet e Barcelonës dhe mendon pozitivisht për ekipin e drejtuar nga Xavi. "Më duket se me ardhjen e Xavit skuadra ka bërë hapa të mëdhenj përpara, falë një gërshetimi të lojtarëve të rinj dhe atyre me përvojë", ka nënvizuar ai. "Në ditët para ndeshjes kundër Holandës, ata filluan të bënin



deklarata dhe të na ngacmonin pak. Kishte disa situata të çuditshme në lojë, me disa lojtarë që sillshin në një mënyrë jo të ndershme, veçanërisht gjatë penalltive. Pas asaj ndeshjeje ata donin që Argjentina të dukej si zuzari i historisë, por atë natë ndodhën shumë gjëra ...", ka theksuar Messi. Për fazën e famshme të tij "Çfarë po shikon, budalla?", ylli argjentinasi pranoi se nuk i pëlqen. "Ishte një veprim i keq nga unë, por këto janë momente të tensionuara dhe

mund të ndodhë". Më pas finalja me Francën: "E kisha pritur gjatë atë moment. Kam luftuar për këtë ëndërr gjithë jetën time". "Gjithmonë kam thënë që nuk mendoj për të ardhmen. Do të luaj derisa të ndiej se nuk mund të duroj më. Koha do ta tregojë. Botërori 2026? Duke ditur moshën që do të jem atëherë (39 vjeç), më duket e vështirë. Pasi të përfundojë karriera ime futbollistike do të kthehem në Barcelonë. Është shtëpia jonë, ku kemi gjithçka", ka përfunduar Messi.

Denveri merr frenat e NBA-s, Bostoni njoftohet me humbje

DENVER, 7 NËNTOR - Denveri mbetet skuadra më e mirë në NBA, me 7 fitore të arritura deri më tani. Më e fundit ndaj New Orleansit, me shifrat 134-116. Sfidë e komanduar nga kampionët, ku shkëlqeu sërish Nikola Jokiq me një "triple double", autor i 35 pikëve, 14 pikëve e 12 reboundeve. Natë për t'u harruar kjo për dy skuadrat e Los Anxhelosit. Ajo e Clippersit u mund me shifrat 111-97 në fushën e New Yorkut. Për vendasit u dalluan Randle me 27 pikë e Barretti me 26. Humbje edhe për laktersat, që në sekondën e fundit u mundën me shifrat 108-107 nga Miami. James realizoi 30 pikë, por që s'mjaftuan, ndërsa për Miamin u dallua Butleri me 28 pikë, mbështetur edhe nga Adebayo me 22 pikë, 20 rebounde e



10 asistime. Milwaukee, falë 36 pikëve e 12 reboundeve të Antetokounmpos, mundi 129-125 Brooklynin jashtë fushës. Në krye të renditjes në Lindje qëndron Bostoni, që u mund me shifrat 114-109 nga Minnesota pas kohës

shtesë. Edwardsi me 38 pikë ishte lider në fushë për vendasit. Fiton edhe Golden State, që mundi me shifrat 120-109 Detroitin, sfidë ku u dallua Curry me 34 pikë.

REZULTATET

Detroit - Golden State	109-120
Indiana - San Antonio	152-111
Orlando - Dallas	102-117
Philadelphia - Washington	146-128
Brooklyn - Milwaukee	125-129
Miami - Lakers	108-107
New York - Clippers	111-97
Chicago - Utah Jazz	130-113
Houston - Sacramento	122-97
Minnesota - Boston	114-109
Oklahoma - Atlanta	126-117
Denver - New Orleans	134-116

SHKURT

Rrahmani humb ndeshjen ndaj Empolit për të luajtur për Kosovën

Napoli do të paraqitet të dielën kundër Empolit pa mbrojtësin Amir Rrahmani. Rrahmani do të luajë të dielën për Kosovën kundër Izraelit. Kështu kanë raportuar të hënën mediet në Itali. "Amir Rrahmani do të jetë në dispozicion të Napolit të mërkurën për ndeshjen kundër Union Berlinit në Ligën e Kampionëve, por do të mungojë të dielën shkak që FIFA ka caktuar që ndeshja e shtyrë në mes të Kosovës dhe Izraelit të luhet në ditën e njëjtë kur Napoli do të luajë ndaj Empolit në shtëpi", shkruan "Corriere dello Sport". Mediumi italian shkruan se Napoli është pajtuar ta lirojë Rrahmanin t'i bashkohet Kosovës për ndeshjen kualifikuese për "Euro 2024". Ndeshja Kosovë - Izrael e planifikuar të luhej më 15 tetor u shty për shkak të situatës në Lindjen e Mesme.

Interi e ka seriozisht interesimin për Ramadanin

Interi po tregon formë të mirë në këtë edicion si në Serinë A ashtu edhe në Ligën e Kampionëve, por kjo nuk e ka penguar dyshen Beppe Marotta e Piero Ausilio për të menduar për përforsime. Në fokus të nënkampionëve të Evropës është vënë një tjetër "legjionar" i kombëtares shqiptare, më konkretisht lideri i mesfushës së Lecces, Ylber Ramadani. Sipas raportimeve më të fundit të medieve italiane, kjo ishte edhe arsyeja pse Ausilio ishte i pranishëm në mitkun "Air Albania" për të ndjekur nga afër përballjen Shqipëri - Çeki, teksa mësohet se vetë italianin tanimë po tenton një marrëveshje me kosto të ulët dhe po përgatitet një ofertë drejt Lecces, e cila nuk pritet të kalojë shifrat e 10 milionë eurove.

Një shqiptar në formacionin e javës në Itali

Serie A mbylli mbrëmjen e së hënës javën e 11-të. Në fushë zbritën shumë lojtarë shqiptarë të cilët rezultuan nga më të mirët për skuadrat e tyre përkatëse. Dysja që bëri shumë bujë ishte ajo e Frosinones, Marvin Çuni dhe Arijon Ibrahimoviq. Të dy sulmuesit gjetën rrugën e rrjetës dhe i dhuruan fitoren Frosinones përballë Empolit të Etrit Berishës dhe Ardian Ismajlit. Madje sulmuesi me orgjinë shqiptare, Ibrahimoviq, është përfshirë edhe në 11-shën më të mirë të kësaj jave në elitën e futbollit italian. 17-vjeçarit i është rezervuar një vend në rolin e trekuartistit pas dyshes së sulmit Lautaro Martinez dhe Colombos së Monzas. Ndërkohë, pjesë e formacionit janë edhe Falcone, Zappa, Bremer, Bijol, Marchizza, Calhanoglu, Pereyra, Miretti, Lautaro dhe Colombo.

Boatengu, afër rikthimit në Bundesliga

Jerome Boatengu u stërvit për një kohë të gjatë me Bayern Munchenin dhe dukej pranë nënshkrimit të kontratës me ish-klubin e tij, por në fund "bavarezët" vendosën të mos firmosin me mbrojtësin. Tani, megjithatë, ka një tjetër klub të Bundesligës që dëshiron shërbimet e tij. Sipas informacioneve të "Sport Bild", ekipi i interesuar është Heidenheim, klub i sapopromovuar në elitë dhe aktualisht i 13-ti në tabelë. Boatengu, 35-vjeçar, do të sillte përvojë në një grup pa lojtarë me emër dhe mund të ishte i dobishëm për arritjen e objektivit të qëndrimit mes më të mirëve. Futbollisti ka luajtur më parë për skuadra si Hertha Berlin, Manchester City edhe Lyon.

Postecoglou pas humbjes ndaj Chelseat: VAR-i nuk më pëlqen, por jam zë i izoluar

Trajneri i Tottenham Hotspur, Ange Postecoglou, në konferencën e shtypit pas humbjes ndaj Chelseat 1-4, është shfaqur shumë i acaruar. Në këtë superduel ndodhën

shumë episode, me gola të anuluar, karton të kuq, rishikime nga VAR, ku Romero braktisi fushën që në minutën e 33-të, ndërkohë që Blutë e Londrës morën edhe një

penallti. "Nëse vazhdojmë të ankohe mi për vendimet e gabuara çdo javë, atëherë do të ndodhë ajo që ndodhi sot (dje), studime në çdo rast. Nuk më pëlqem. Mund të jem një

zë i izoluar sepse më është thënë se kjo është rruga për t'u ndjekur, por në një moment të caktuar duhet ta pranojmë vendimin e gjyqtarit. Në të kundërt, ata nuk do të kenë

asnjë autoritet dhe ne do të jemi nën kontrollin e dikujt që ndodhet disa kilometra larg, duke parë një ekran televiziv", ka thënë Postecoglou për "Sky Sports UK".

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Biznesi "HAVOLLI DEKOR" SH.P.K. ne numër unik: 811548611, njofton opinionin për uljen e vlerës së kapitalit të biznesit nga 10,000 euro ne vlerën 1,000 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sazan Berisha shpall te pavlefshme 3 dëftesat , diplomën , vërtetimin e lëshuar për gjendjen e notave Q.K. "11 Marsi " Prizren.

- Mentor Thaci shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.

- Djellza Islami nga Gjakova, shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi".

- Shkëndije Lipoveci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplmën e shkollës së mesme "Milladin Popoviq".

- Evelina Huma nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme "Kadri Kusari".

- Berat Myrta nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësisht mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësisht na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësisht na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

